

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4898/1 datë 22.11.2024, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2253/1 datë 29.05.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2840/3 datë 07.07.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 2-të mbajtur më 07.07.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, për shkeljen e kryer të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, transmetuar më 2 maj 2025, disa emisione janë transmetuar me aplikim të gabuar të sinjalizimit paralajmërues për program të kategorisë së dytë. Në tërësinë e pamjes së përcaktuar të sinjalizimit paralajmërues në fillim dhe gjatë kohës së transmetimit mungon numri „8“ dhe shenja „+“, si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilët është destinuar programi.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2253/1 datë 29.05.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – vërejtje publike në rastet kur është kryer shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit nuk duhet të transmetojnë ose të shfaqin programe që mund seroizisht të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, në veçanti programe me përmbajtje pornografike ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve, me kërkesë duhet të ndërmarrin masa teknike më të rrepta për të siguruar që të miturit të jenë të mbrojtur nga përmbajtje të dëmshme siç është dhunë e tepruar dhe pornografi. Përveç programeve nga paragrafi (1) të këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, sigurohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë që të miturit të mos mundë në mënyrë të zakonshme t'i shohin ose dëgjojnë programet. Kur programet transmetohen ose ritransmetohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual është i detyruar para transmetimit të tyre të sigurojë paraprakisht paralajmërim akustik dhe mundësinë për t'i njohur me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 të LSHMAAV).

Në nenin 20 të RRMPM është përcaktuar mënyra e aplikimit të sinjalistikës paraalajmëruese. Në përputhje me paragrafin (1) nga Ligji i njëjtë para fillimit të programeve televizive që përfshihen me nenin 19 të kësaj Rregullore (Përmbajtje në të cilën aplikohet sinjalistika paraalajmëruese), detyrimisht transmetohet sinjali paraalajmërues që korrespondon me kategorinë e programit dhe është kombinuar me shenjë vizuale, tekstin, paraalajmërimin verbal dhe akustik, zgjatë së paku 10 sekonda dhe mbulon së paku 1/4 të pjesës që shihet të ekranit.

Në nenin 21 të RRMPM (Pamja dhe përmbajtja e sinjalistikës paraalajmëruese), ndër të tjera është përcaktuar se sinjali paraalajmërues që aplikohet para, deri ose gjatë programeve nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale për programet e klasifikuara të kategorisë së dytë, duhet të qëndron numri „8“ dhe shenja „+“, si dhe të shkruhet teksti i paraalajmërimit: „Programe të kategorisë së dytë që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 8 vjeçare Rekomandohet mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari.“

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, me datë 29 maj 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, transmetuar më 2 maj 2025, në nivel rajonal, nga ku është konstatuar shkelja e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të RRMPM.

Gjegjësisht, nga mbikëqyrja e rregullt programore mbi shërbimin programor televiziv të SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, transmetuar më 2 maj 2025, në nivel rajonal, është konstatuar shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të RRMPM. Në kundërshtim me nenet 20 dhe 21 të RRMPM, në shërbimin programor televiziv të transmetuesit më 2 maj 2025, me aplikim të gabuar të sinjalistikës për program të kategorisë së dytë (8+), janë transmetuar disa programe të paraqitura në tabelën që përmban Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2253/1 datë 29.05.2025. Në fillim dhe gjatë transmetimit të programeve të kategorisë së dytë (8+), në tërësi të pamjes së parashikuar me ligj të sinjalistikës paraalajmëruese të zbatuar për program të klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon: numri „8“ dhe shenja „+“, si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilin është destinuar programi.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2253/1 datë 29.05.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, me datë 30.05.2025, ka dërguar Shkresë me nr.ynë ark.10-2253/2 datë 30.05.2025, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-2253/1 datë 29.05.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe të RRMPM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 05.06.2025. Në afatin e parashikuar, përkatësisht më 09.06.2025, SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, drejtuar Agjencisë ka dorëzuar deklaratë me shkrim nr.ynë ark.10-2253/3 datë 09.06.2025. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 07.07.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën me shkrim të dorëzuar nga transmetuesi dhe konkludoi që SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP t'i shqiptohet masë- vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 20 dhe 21 të RRMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastuar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2253/1 datë 29.05.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2840/3 datë 07.07.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 2-të mbajtur më 07.07.2025, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paraalajmëron SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-2253/1 datë 29.05.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuel
Kraetar i Këshillit
Mr. Sasho STEFANOVSKI**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritje të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.